

Ditari Natyres

“Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC Shqipëri në kuadër të programit SENiOR-A
“Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri”. Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze”
Nr. 17 Viti i dytë i botimit Tetor 2014

Në këtë numër do të gjeni:

- Lançohet nisma e shoqërisë civile “Shqipëria Pa Duhan”
- Ishulli i Sazanit, një zonë e re e mbrojtur në Shqipëri?
- Ruajtja e Pelikanit Dalmatian
- Trashëgimia natyrore, një përparësi për zhvillimin e turizmit
- Takimi i dytë për aktorët Pan-European të IPBES
- Njoftime

Lançohet nisma e shoqërisë civile “Shqipëria Pa Duhan”



Lançohet nisma e shoqërisë civile “Shqipëria Jo Duhanit!”

**Ftojme të gjithë shqiptarët t'i bashkohen nismës
duke i thënë Ndal! Duhanpirjes**

Tiranë, 05/09/2014 – “Shqipëria Jo duhanit” është nisma e shoqërisë civile e lançuar sot nga disa organizata dhe aktorë të shoqërisë civile të drejtuar nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës (INCA), të mbështetur nga Ministria e Shëndetësisë, me synim informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për t'i thënë ndal duhanpirjes. Në takimin hapës, përfaqësuesit e shoqërisë civile shpallën krijimin e aleancës kundër duhanit, duke u shprehur se janë rreshtuar në një llogore me nismën e Qeverisë për t'i thënë stop duhanpirjes.

Në takim përveç përfaqësuesit të INCA-s, si përfaqësues të Grupimit Organizatave Shoqërisë Civile Anti-duhan (GOSHA) folën dhe mbështetën iniciativën edhe znj. Kozara Kati e Qendrës

Vijon në faqe 2



Organizatat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



SHOQATA MJEDISORE CAJUPI
Bashkejeto me Natyrën



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri



Vijon nga faqe 1

Shqiptare për të Drejtat e Njeriut (QSHDNJ), Mentor Kikia i Forumi i Mendimit të Lirë, si edhe Sonila Mlloja e Lidhjes Gazetarëve të Shëndetësisë. Në takim mori pjesë dhe Ministri i Shëndetësisë, z. Ilir Beqaj, i cili e përshëndeti nismën, duke theksuar se kjo është një sfidë e Qeverisë dhe e tij personale, jo vetëm për domosdoshmërinë e një shëndërrimi rrënjësor dhe përmirësimit të shëndetit publik, por edhe për faktin, se është tentuar dhe herë të tjera dhe nu nuk ka qenë e suksesshme, çka e bën atë një sfidë të dyfishtë. Ministri i Shëndetësisë u shpreh se është një përpjekje që duhet ta bëjmë bashkërisht, duke përcjellë mesazhin edhe te rinia se, duhanpirja është realisht e dëmshme për shëndetin.

Ndërkohë, z. Zamir Dedej nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës, bëri thirrje që të gjithë shqiptarët t'i bashkohen kësaj nismeje, për t'i thënë JO! një plage të shoqërisë, siç është ajo e duhanpirjes. Ndërsa përfaqësuesit e Lidhjes së Gazetarëve të Shëndetit e vunë theksin te rëndësia që ka media për të përcjellë nëpërmjet historive reale, dëmet e pamata që shkaktohen ndaj shëndetit nga duhanpirja, për ata që

e konsumojnë, por edhe për duhanpirësit pasivë, që në fund të ditës ndihen po aq të kërcënuar nga duhani edhe pse mundohen t'i qëndrojnë larg atij.

Në takim u shpall numri i gjelbër **0800 40 40**, ku çdokush mund të denoncojë raste të pirjes së duhanit në mjedise publike, në shkelje të kërkesave të ligjit, si dhe një faqe e posaçme online, dedikuar denoncimeve të këtyre rasteve, por edhe këshillave për të lënë duhanin. Për më tepër informacion për këtë faqe, mund të gjeni duke klikuar link-un e mëposhtëm: <http://shqiperiajoduhanit.al/>.

Gjithashtu, faqja online e nismës “Shqipëria Jo Duhanit!” ofron mundësinë, që me anën e një aplikacioni online në pajisje PC, Laptop, apo edhe Tablet ose Smartphone, me anë të një videoje, fotografie ose thjesht, teksti, të mund të denonconi rastet e duhanpirjes në mjedise publike, qofshin këto institucione shtetërore, biznese private, bare e restorante apo edhe ndërmarrje të ndryshme ku punonjësit shkelin ligjin e duhanit.

Aplikacionin online për denoncimin e kundravajtësve mund ta gjeni këtu:

<http://shqiperiajoduhanit.al/denonco.php>

Ishulli i Sazanit, një zonë e re e mbrojtur në Shqipëri?

Vlorë, 17-19 Shtator 2014 - Në kuadër të zhvillimit të planit të menaxhimit të Parkut Detar Karaburun-Sazan dhe atij të Ishullit të Sazanit, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) së bashku me Zyrën e WWF, Programit për Mesëdheun (WWF MedPO) dhe Conservatoire du Littoral (CdL), si dhe në bashëpunim me Ministrinë e Mjedisit, organizuan 2 takime të njëpasnjëshme: workshopin 2 ditor “Zhvillimi i zonimit të propozuar”, i cili u vijua me

workshopin një ditor “Ishulli i Sazanit, një zonë e re e mbrojtur? Një plan Menaxhimi për Ishullin e Sazanit”.

Përveç objektivave të ndryshme që kishin të dy takimet, të dy u zhvilluan për të njëjtën çështje, zhvillimin e planit të parë të menaxhimit për Parkun Detar Karaburun-Sazan dhe atij të Ishullit të Sazanit. Plani i menaxhimit është një instrument i rëndësishëm për zhvillimin e mekanizmave drejt zhvillimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura, por njëkohësisht edhe të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të zonës përreth.

Të dy workshopet kishin për qëllim rritjen e kapacitetve në stafin e institucioneve përgjegjëse, autoriteteve lokale, menaxherëve të Zonave të Mbrojtura, OJQ etj, duke i ndihmuar me të gjithë mekanizmat për përmirësimin e menaxhimit ekzistues të Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare, dhe të asistojnë në zhvillimin e Planeve të Menaxhimit në proces.



Ruajtja e Pelikanit Dalmatian

Kirkini, Greqi 22-26 Shtator 2014 - Në kuadër të fillimit të zbatimit të projektit “Ruajtja e Pelikanit Dalmatian dhe programit të menaxhimit të ligatimave në Mesedhe-Karavasta, Shqipëri”, në datë 22-26 u zhvillua takimi i parë me përfaqësuesit e institucioneve dhe partnetrëve përgjegjës për zbatimin e këtij projekti, i cili zbatohet si një nismë rajonale në katër ligatina në rajon, Liqeni i Shkodrës (Mal i Zi), Liqeni Presës (Greqi), Liqeni Kirkini (Greqi), Laguna e Karavastasë (Divjake).

Ky takim kishte për qëllim prezantimin e linjave të përgjithshme të projektit dhe në mënyrë specifike objektivave dhe aktiviteteve për secilën vend. Përfaqësuesit ndanë eksperiencat e mëparshme lidhur me ruajtjen dhe menaxhimin e dëritanishëm të Pelikanit Dalmatian dhe ruajtjen e ekositemit rreth tij në këto ligatina, duke dhënë mundësinë e përfshirjes së komunitetit lokal dhe shndërrimit të zonave në atraksione për turistet dhe studiuesit. Gjithashtu ky takim ishte një mundësi shumë e mirë për



përfaqësuesit e vendeve që nuk kanë histori të mirëfilltë konservimi të pelikanit (laguna e Karavastasë). Gjatë jetës së projektit pritet të zhvillohen edhe 2 takime të tjera për ecurinë e projektit dhe shëmbimin e ekperiencave midis partnerëve në rajon.

Trashëgimia natyrore, një përparësi për zhvillimin e turizmit

Gjirokastrë 26-28 Shtator 2014 - Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe Shoqata Mjedisore “Çajupi”- Gjirokastrë, pjesë të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës që mbështetet nga Projekti



SENiOR-A (Qendra Rajonale e Mjedisit-REC Albania), morën pjesë në Panairin e 8 të Kombëtar të Trashëgimise dhe Artizanatit “Gjirokastra 2014”.

Intergrimi i zonës së Gjirokastrës në ekonomine rajonale me një vlerësim maksimal të resurseve dhe

një menaxhim të qëndrueshëm të tyre, nxjerr domosdoshmëri mbrojtjen dhe evidentimin e zonave me vlera natyrore të këtyre trevave si sipërfaqe me vlera të veçanta të peisazhit e të biodiversitetit, por që mbartin edhe vlera kulturore, historike, arkeologjike e të trashëgimisë kulturore. Kjo do të jetë motoja dhe qëllimi i pjesmarrjes sonë në këtë aktivitet.

Për këtë arsye dhe në kuadër të këtij eventi, ishte prezent edhe një post në panair për promovimin e vlerave natyrore të zonës dhe jo vetëm si dhe u organizua një tryezë me titull “Trashëgimia natyrore, një përparësi për zhvillimin e turizmit në zonën e Gjirokastrës” në datën 28 Shtator në ambientet e Vilës Babameto. Në këtë tryezë u promovua biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura si trashëgimi natyrore me vlerë për zhvillimin e zonës si dhe vlerat natyrore dhe kulturore të zonës së Përmetit dhe bashkëpunimi ndërkufitar Shqipëri-Greqi. Një vend të veçantë zuri edhe Viroi, një oaz natyror për qytetin e Gjirokastrës

Takimi i dytë për aktorët Pan-European të IPBES

Bazel, Zvicër 22-23 Shtator 2014 - IPBES, është shkurtimi për Platformën Ndërqeveritare për Biodiversitetin dhe Shërbimet Mjedisore (Intergovernmental Platform for Biodiversity and Ecosystem Services), e cila ka filluar të zbatohet këtë vit planin e punës të aprovuar në Konferencën e Palëve të Konventës së Biodiversitetit për periudhën 2014-2018. Një nga detyrat kryesore të kësaj platforme është të zhvillojë një vlerësim për biodiversitetin dhe shërbimet mjedisore në nivel rajoni dhe sub-rajoni. Proçesi i strukturimit të studimit do të përfundojë në takimin plenar të Platformës, IPBES-3 (Janar 2015), me qëllim që të fillojë vlerësimi rajonal në vitin 2015.

Në këtë konteskt, z. Zamir Dedej, me ftesë të Forumit Zvicerian të Biodiversitetit, mori pjesë në takimin konsultativ për vendet e rajonit Pan-European (Europa dhe Azia Qëndrore) të zhvilluar në Bazel të Zvicerës në datat 22-23 Shtator. Takimi zhvillohej në vazhdim të takimit të parë të zhvilluar

me sukses në Laipzig në Korrik 2013, dhe përfshinte një numër më të madh specialistësh shkencorë, ekspertë lokal, politik bërës dhe OJF, për ta bërë sa më të gjërë informacionin dhe përfshirjen e mendimit të interesave të ndryshëm. Më konkretisht takimi kishte si objektiva kryesor:

- Të informonte për proçesin e deritanishëm të IPBES-it, dhe si mund të merret pjesë në këtë program;
- Të diskutonte dhe të merrte kontribute për vlerësimin e ardhshëm IPBES që do të bëhet në nivel rajonal për Europën dhe Azinë Qëndrore;
- Të kontribuonte për mobilizimin e ekspertëve dhe aktorëve në rajonin Pan-European dhe atë të Azisë Qendrore.

Për më shumë informacion mund të vizitoni faqet:

<http://ipbes.net/stakeholders/stakeholder-processes/343-ipbes-stakeholder-forum.html>

<http://ipbes.net/events-feed/363-eastern-eu-regional-consultation.html>

NJOFTIME

- 1- Jobs at Plant life Volunteer Coordinator (Plant surveys)
http://www.plantlife.org.uk/about_us/jobs_at_plantlife/.
- 2- Opportunities of Study in Japan
http://www.it.emb-japan.go.jp/italiano/albania/scholarship_2015.html
- 3- Japanese Government. Scholarship for 2015 (Research student)
http://www.mext.go.jp/a_menu/koutou/ryugaku/boshu/1346643.htm

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në ditarin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

- Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania